

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me procesmbajtjen Mimoza Mehmeti, në qështjen penale ndaj të akuzuarit S.M, nga fsh. T., Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë.24.10.2016 ndërsa më date mori dhe shpalli këtë :

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari S.M.** pa pseodonim dhe emër të rrejshëm, nga babai I. dhe nëna E...., e lindur F..., i lindur më ....., në fshatin T., Komuna e Kamenicës, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i pesë fëmijëve , i gjendjes së varfër ekonomike , më pare i pa gjykuar dhe nuk zyhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Sepsem më datë 17.04.2016., rreth orës 20.00 minuta, në fsh. S. deri sa ka qenë duke e drejtuar automjetin të markës "M C.", me targa të regjistrimit..... e ka rrezikuar trafikun publik , duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që me të arritur në afërsi të urës së fshatit S., duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes automjetit të tij , kushteve të tënë rrugën lokale M. –S., me të arritur tek ura e fsh. D., i rrugës në vendbanim , në mënyrë që automjetin e vet ta ndalë para çdo pengese e në kundërshtim me dispozitën e nenit 54.1 të Ligjit për Sigurinë e komunikacionit rrugor , kështu me pjesën e përparme të automjetit e godet këmbësorin B.J., i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë kundrejt lëvizjes së automjetit , e të cilin e përplasë për tokë , me që rast i shkakton lëndime të lehta trupore , për qka detyrohet të kërkoj ndihmë mjeksore në Spitalin Regjional në Gjilan .

- me qka ka kryer veprë penale **rrezikimi i trafikut publik**, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë nenit 4, 41, 51, 64, 73, 74, 75 i dhe 365 të KPRK-së,

## **E G J Y K O N**

*Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i,të ciln dënim i akuzuari i ekzekutuari nuk do ta mbajë në qoftë në afat prej 1(një) viti,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ,në të kundërtën dënimi i kushtzuar do të revokohet .*

*I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të paguanëj shumen prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e ploëtfuqishmërisë së këtij aktgjykim me kanosje përmbarimi.*

*I dëmtuari B.J. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.*

### **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. 737/2016 prej datës 02.05.2016 e ka akuzuar S.M. ,nga fsh.T. , për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se.*

*Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani ,në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: se mbetem pran aktakuzës së ushtruar me shkrim,dhe propozoj që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të njëjtit ti shqiptohet një dënim meritor sipas kodit penal, gjithnji duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese ..*

*I akuzuari S.M.,në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranoj fajsinën për veprën penale si në aktakuzë,pendohem për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se i premtojm gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk do të bie ndesh me ligjin ,se këtë pranim e bëjë në mënyrë vullnetare dhe se jam në dijeni për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë .*

*Meqense i akuzuari në seancën gjyqsore të kësaj qështje penale e ka pranuar fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike nuk është kontestuese ,sepse porpos pranimit të fajsisë nga ana e të akuzuarit një pranim i tillë ka edhe mbështetje në provat e grumbulluara të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajsinë ,se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë dhe se aktakuza nuk përmban as një shkelje ligjore ,andaj gjykata vazdoj procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtimin gjyqësor kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 paragrafi 5 te KPPK-së.*

*Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin së dënimit, për të akuzuarin , gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më butë apo më i rëndë, ashtu si që e parashifet me dispozitën e neneve 73 dhe 75 të KPRK-ës. Kështu si rretanë lehtësuesi për të akuzuarin gjykata pati parasysh*

*pranimin e fajsisë qka do të thotë se i akuzuar ka pranuar të jet bashkëpunues, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndeshë me ligjin, si dhe gjendjen e varfër ekonomike .Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjesis penale, rrezikshmërin shoqrore sikur edhe pasojën e e shkaktuar nga kjo vepër penale .Andaj gjykata erdhi në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandaloj që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.*

*Për shpenzimet shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag 1, e në lidhje me nenin 450 para.2 . 6 të KPPK-ës.*

*Gjykata konform nenit 463 parag.të KPRK-së të dëmtuarës , për realizimin e kërkesës pasurore juridike,udhëzohet në kontest civil.*

*Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEGA NOVOBERDE**

*Departamenti i përgjithshëm*

**P.nr.30/2016,Më 20.09.2016**

***Proqesmbajtsja  
Mimoza Mehmeti***

***Gjyqtari  
Hasan Sadiku***

***KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.***

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me praktikantin Nusret Ramadani, në lëndën penale ndaj të akuzuarit F.I. nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedimi I pa autorizuar I narkotikve ,substancave psikotropike ose analoge ,nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.249/2017, të cilën e përfaqësonte prokurori e shtetit Mr.sc .Ismet Ukshini, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqsor oral dhe public, të mbajtur më 27.02.2017 ndërsa më 28.02.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari F.I.** pa pseodonim dhe emër të rrejshëm, nga ati S. dhe nëna Z...., e lindur S..., i lindur më ....., në Gjilan me vendbanim në rrugën ”,R.M”.nr... A me vendbanim të përkoshëm në Minhen të Gjermanisë , shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme ,me profesion kopshtar i martuar, pa fëmijë ,i gjendjes së së mesme ekonomike ,më parë i pa gjykuar dhe nuk zyhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij.

**Ë s h t ë f a j t o r**

Sepse:

Më datë 01.02.2017., rreth orës 21:30 min, në fsh.S.Komuna e Novobërdës në mënyrë të pa autorizuar ka poseduar substanca narkotike ,në atë mënyrë që deris a i akuzuari kishte qenë dduke drejtuar automjetin e markës „M” “M C..”, me targa të regjistrimit....është ndalur nga ana e policisë ,dhe me rastin e kontrollimit fizik tek i pandehuri është gjetur substancë narkotike në sasi prej 2.3gram ,dhe një cugare e mbështjellë në sasi prej 1.3gram ,me c’rastpas bërjes së testit fushor ka rezultuar se substancat narkotike ishin të llojit marihuanë

- me çka ka kryer vepër penale Posedim i pa autorizuar i narkotikve ,substancave psikotrike ose analoge , nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë nenit 4, 41,45.46,62,73,74dhe ,76 i dhe 365 të KPRK-së,

## **E G J Y K O N**

*Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,të ciln dënim nuk ka për tu ekzekutuar në qoftë në afat prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në të kundërtën dënimi i kushtzuar do të revokohet dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 €(treqindë) euro ,të cilën shumë i akuzuari ,i larëcekur do ta arkëtoj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë .*

*Nëse i akuzuari refuzon që ta arkëtoj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje e ta arkëtoj ,athere dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim ,në at mënyrë qe për çdo 20 €,të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim .*

*Nga i akuzuari konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë”në sasi prej 2.3 gram dhe një cigare në sasi prej 1.3 gram.*

*Obligohet i akuzuari që ti paguanë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si paushallin gjyqësor, shumën prej 25 € .shumen prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plothuqishmërisë së këtij aktgjykim me kanosje përmbarimi.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan,, me aktakuzën e ushtruar PP.II.nr. 249/2017 prej datës 07.02.2017 e ka akuzuar F.I.,nga Gjilani, për shkak të veprës penale Posedim i pa autorizuar i narkotikve ,**substancave psikotrike ose ana loge** , nga neni 275 paragrafi1 të KPRK-së.*

*Prokurori i shtetit Mr.sc .Ismet Ukshini,në seancën fillestare ka deklaruar: mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim dhe propozoi që e i akuzuari të shpallet fajtorë për veprën e kryer dhe të njejtiti ti shqiptohet dënimi meritore sipas ligjit gjithj duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat sikur ato lehëtsuese ashtu edhe ato rënduese.*

*I akuzuari F.I,në seancën fillestare ka deklaruar: aktakuzën e lexuar nga ana e prokurorit të shtetit e kam kuptuar në tërësi ,se e pranoj fajsinën për veprën penale si në aktakuzë,pendohem për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se i premtojm gjykatës se në të ardhmë do të kryej vepra tjera penale .*

*Me qenë se i akuzuari në shqyrtimin fillestar të mbajtur pranë kësaj gjykate në këtë qështje penale e ka pranuar fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike nuk është kontestuese ,sepse porpos pranimin të fajsisë nga ana e të akuzuarit, një pranim i tillë ka edhe mbështetje edhe në provat e grumbulluara në shkresat e lëndës sic janë raporti fillestar i incidentit dhe raporti i shpejtë ,deklaratat e dëshmitarëve L:SH.dhe F.J.,vërtetimet mbi sekuestrimin e përkoshëm të sendeve ,se i njëjti vullnetarisht e ka pranuar fajsinë , ,se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë dhe se aktakuza nuk përmban as një shkelje*

ligjore ,andaj gjykata vazdoj procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtimin gjyqësor kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 paragrafi 4 të KPRK-ës..

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë së dënimit, për të akuzuarin , gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat ikurës ato lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë përcaktimin e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-ës,dhe kështu si rretanë veqanarisht lehtësuese për të akuzuarin,gjykata pati parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer sjelljen korrekte para gjykatës , si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të ndërmer veprime të këtilla gjendja ekonomike familjare ,se sasia e narkotikut te gjetur tek i njëjti e ka pasur për nevojat e veta pasi që në shkresat e lëndës konstatohet se i njëjti merret me konsumimin e narkotikve që nga viti 2004e këndeje,ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjshis penale, rrezikshmërin shoqrore sikur edhe pasojën e shkaktuar nga kjo vepër penale .Andaj gjykata gjeti se me dënimin e shqiptuar nda të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandaloj që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Vendim për shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të dispozitës së nenit 450 të KPPK-ës.

Ndërsa vendimi mbi konfiskimin e narkotikut u bazua në dispozitën e nenit 62 par.1,2nën para 2.7 të KPRK-ës.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEGA NOVOBERDE**

*Departamenti i përgjithshëm*

**P.nr.11/2017,më 28.02.2017**

**Gjyqtari**

**Hasan Sadiku**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.